

1 E hënë, 11 shtator 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes]

5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 9.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sekretare
8 e Gjykatës, mund të paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Kjo është
10 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
11 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të mbyllim
13 dëshminë e Dëshmitarit 04408 sot.

14 Vërej për procesverbal, që të gjithë të akuzuarit janë të
15 pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit, me përjashtim të z.
16 Krasniqi, që na ndjek me videolidhje, për të cilën i është
17 dhënë leja.

18 Asistente, mund të sillni dëshmitarin brenda në sallën e
19 gjyqit.

20 Z. TIEGER: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, përpara se të
21 vijë dëshmitari, a mund të them se kemi një kërkesë në pritje
22 për të cilët kërkohet miratimi për të shtuar dokumente në
23 listën e prezantimeve. Normalisht nuk dua ta shtyj praninë e
24 dëshmitarit, po ka pasë një kundërshtim në lidhje me këtë dhe
25 doja që të vihej në dukje.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, cili
2 është kundërshtimi.

3 Z. TIEGER: [Përkthim] Fillimisht do të doja të thoja
4 diçka sa i takon afatit këto dokumente janë dorëzuar mbrëmë në
5 orën 9.00 të darkës, pasi ishte dhe e diel, në fundjavë. Unë
6 kam qenë, më është dashur të rishikoj këto dokumente, të cilët
7 erdhën realisht shumë vonë. Megjithatë, pavarësisht ne nuk
8 kundërshtojmë dokumentet po me përjashtim të njërit. Që është
9 dokumenti DHT01486-DHT01488, që është përmbledhje e një
10 dëshmitari i cili ka dëshmuar më herët edhe mendoj që nuk ka
11 asnjë vlerë provuese në fakt nga kjo përmbledhje apo për të
12 thënë këtë përmbledhje.

13 Dhe gjithashtu duhet të kuptoni që ka disa kufizime
14 praktike sepse nuk është fare në Legal Workflow.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po është
16 përmbledhje e z. Mustafa.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, është dorëzuar nga Prokuroria.
18 Dhe ne kemi disa pyetje në lidhje me këtë, nëse disa nga
19 gjërat përputhen sa i takon rolit të z. Demaçi. Kemi pasur
20 disa çështje, disa pyetje nga Trupi Gjykes në lidhje me këtë.

21 Prokuroria këtë ka thënë sa i takon komenteve që ka dhënë
22 z. Remi për z. Demaçi dhe ajo që kemi dashur të bëjmë ne është
23 thjesht të shohim: A ka përputhje apo është në koherencë me
24 mënyrën si është kuptuar roli i tij, a ka qenë rol sa për
25 figurë apo ka qenë një rol më i rëndësishëm, pra, ne duam të

1 kuptojmë si e keni kuptuar ju rolin e tij?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta lejojmë
3 dokumentin.

4 Unë kam një pyetje sa i takon dokumentit të Rambujesë.
5 Nuk e kuptoj dot çka lidhje. Sepse askush s'e ka përmendur
6 Rambujenë, s'është përmendur fare Konferenca e Rambujesë.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar] Për cilin
8 dokument e keni fjalën?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ja do të
10 duhet ta gjej një sekondë.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të kalojmë një sekondë në
12 seancë private sepse është diçka, nëse bëhet fjalë për
13 dokumentin që mendoj unë se e keni fjalën, është një dokument
14 që unë dhe z. Tieger e kemi diskutuar edhe diskutohet dhe e
15 mira është që kjo të bëhet në seancë private.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT01485. Për
17 këtë e keni fjalën?

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Besoj se ky është përgjimi. A mund
19 të kalojmë në seancë private që të flasë lirisht? E keni
20 fjalën për dokumentin DHT01485?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. 1485.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të kalojmë në seancë private
23 sepse Prokurori me të drejtë i ngriti pyetjet edhe ne që t'i
24 shtjellojmë më tej duhet të flasim në seancë private.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk do

1 flasim tani. Por me sa kuptoj unë, nuk ka asnjë kundërshtim
2 nga ZPS-ja për këtë. A e kam kuptuar siç duhet?

3 Z. TIEGER: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime për shkak
4 të afatit, po me sa kuptova unë, nuk ka asnjë kundërshtim për
5 dokumentet që janë lidhur në lidhje me z. Demaçi.

6 Me sa kuptova unë nga dokumenti, që i hodha një shpejt e
7 shpejt, një lidhje me këtë është. Do ta shoh pak me imtësi
8 tani. Do ja lë Trupit Gjykues të vendosi. Po nuk kemi
9 kundërshtim ne për kohën kur është dorëzuar dhe nuk kemi
10 kundërshtim sa i takon faktit që në fakt lidhet në thelb me z.
11 Demaçi.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt, më
13 mirë të fillojmë tani. Ka të ngjarë që këto dokumente ne do
14 t'i shohim sidoqoftë. Kështu që, për momentin, unë them në
15 qoftë se kjo nuk shkon përtej kuadrit të pyetjeve të
16 Gjykatësit, ne do t'i trajtojmë.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kemi dëgjuar asnjë
18 kundërshtim por dhe ne kemi shtuar në listën tonë të
19 prezantimeve për shkak të disa pyetjeve që u bënë Rezolutën e
20 Kombeve të Bashkuara që është Rezoluta 1244.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'ka asnjë
22 kundërshtim për këtë dokument.

23 Vazhdojmë tani. Mund të vijë dëshmitari brenda në sallë.

24 [Dëshmitari vijon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes

1 z. Abrahams.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të
4 mbyllim dëshminë tuaj me kundërpyetjet, në fakt, jo me
5 kundërpyetjet, po me pyetje vijuese nga Ekipet e Mbrojtjes të
6 cilat burojnë nga pyetjet që u kanë drejtuar Gjykatësit.

7 Ju kujtoj t'u përgjigjeni pyetjeve qartë me fjali të
8 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni që ta
9 shpjegojnë apo ta përsërisin pyetjen edhe sigurisht që ata do
10 të përpiqen që ta sqarojnë sipas nevojës. Gjithashtu, na thoni
11 ku e bazoni njohurinë tuaj lidhur me faktet dhe rrethanat për
12 të cilat do t'ju bëjmë pyetje.

13 Ju kujtoj që keni ende detyrimin për të thënë të vërtetën
14 sikurse e thatë vetë përmes deklaratës solemne. Mos harroni të
15 flisni para mikrofonit, të flisni ngadalë për hir të
16 përkthimit. Nëse keni nevojë për pushim, na thoni dhe do t'ua
17 plotësojmë këtë kërkesë.

18 E di që z. Emerson dhe z. Kehoe kishin plan t'i bënin
19 pyetje.

20 Z. Roberts, ju keni pyetje në vijim të pyetjeve të
21 Gjykatësve?

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ellis?

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, nuk kam synim për momentin të
25 bëj pyetje.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. E
2 kuptojmë që mund të dalin gjëra të reja se dhe do ta marrim
3 parasysh këtë gjë.

4 Do të vazhdojmë me dëshminë tani e Dëshmitarit 04408.
5 Trupi Gjykues lejon Mbrojtjen e Thaçit dhe Mbrojtjen e Veselit
6 t'i bëjnë pyetje dëshmitarit sa u takon pyetjeve që kanë
7 buruar nga Trupi Gjykues.

8 Duke pasur parasysh kuadrin dhe kohëzgjatjen e këtyre
9 pyetjeve, Trupi Gjykues mendon se një orë ju mjafton ekipeve
10 të mbrojtjes për të bërë pyetje shtesë. Pra, kini parasysh
11 secili keni nga një orë edhe besoj që kjo është e qartë për të
12 dyja palët dhe mendoj që është krejt e përshtatshme për ju.

13 Do ju kujtoj kur t'ju ketë ngelur dhe nga pesë minuta.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit.

15 DËSHMITARI: W04408 [Vijon]

16 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe:

17 Z. KEHOE: [Përkthim]

18 PY. Mirëmëngjes, z. Abrahamas. Sikurse u thanë, do të flasim
19 lidhur me disa nga pyetjet që ju bënë Gjykatësit. Prandaj në
20 qoftë se do përsëris diçka, çështje, ju lutem kini durim. Por
21 kini parasysh që do bëjmë pyetje shtesë vetëm për pyetjet që
22 kanë bërë Gjykatësit, pra, pyetjet tona burojnë nga pyetjet e
23 Trupit Gjykues.

24 PË. Patjetër.

25 PY. Ishte një pyetje që u bëri Gjykatësi Barthe.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] E cila është pasqyruar në faqen

2 7570, rreshti 13 deri në 20 të transkriptit.

3 PY. Një pyetje nëse z. Thaçi dhe z. Limaj, pra, jemi në 10
4 nëntor, flasim për takimin e 10 nëntorit. Nëse z. Thaçi apo z.
5 Limaj a thanë ndonjë gjë prej gazetarëve serbë dyshohej të
6 ishte përfshirë në veprimtari kriminale në Republikën serbe të
7 Krajinës dhe/ose në Bosnjë në vitin 1991 ose 1992. Dhe ju u
8 përgjigjët: Jo nuk ka dalë kjo gjë. Ju kujtohet?

9 PË. Po.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Atëherë nëse është e mundur dua që
11 të shfaqet në ekran prova materiale numër 300. Prova materiale
12 300, P300.

13 PY. E keni parë këtë dokument edhe më herët. Është prova
14 materiale P300. Që është në fakt deklarata numër 3, kumtesa
15 numër 3 që pretendohet se ka dalë nga drejtoria e policisë së
16 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, policisë ushtarake. Unë do
17 filloj:

18 "Të dielën më 18 tetor të këtij viti rreth orës 15.00 të
19 pasdites, patrulla e policisë ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare
20 të Kosovës ka hasur në veturën e tipit Yugo Florida me
21 regjistrim të Beogradit afër fshatit Magurë pa shenja të
22 shtypit me shofer dhe pasagjer Vladimir Dobricic dhe Nebojsa
23 Radosevic. Pas dhënies së shenjës së ndalimit, ata janë ndalur
24 me vonesë, duke u munduar pastaj ta fshehin identitetin e
25 tyre. Kjo ka bërë që dyshohej sa i takon identitetit të tyre,

1 duke mos u besuar se janë gazetarë dhe se qëllimi i tyre ishte
2 spiunazhi.

3 Ata janë ndaluar dhe i është caktuar paraburgim me qëllim
4 që të hetohet profesioni, identiteti i saktë dhe qëllimi i
5 udhëtimit të tyre".

6 A pajtohem me mua, z. Abrahamas, kjo kumtesë lë të
7 kuptosh që në fakt gazetarët janë ndaluar sepse nuk kishin
8 identifikuar si pjesëtarë të shtypit dhe mendohej se po
9 fshihnin identitetin?

10 PË. Pajtohem, që bazuar në këtë kumtesë, ky është pretendimi
11 që është ngritur nga drejtorja e policisë ushtarake.

12 PY. Dhe po ashtu këtu propozohet apo thuhet se dyshoheshin si
13 persona të përfshirë në spiunazh?

14 PË. Ky është pretendimi i ngritur nga drejtorja e policisë.

15 PY. Unë po them, që hetuesit e TPNJ-së dolën në përfundimin
16 që z. Dobricic ka qenë i përfshirë në kryerjen e krimeve të
17 luftës në Kroaci në 1991 dhe këtë e ka bërë duke përdorur të
18 dhëna sikur është pjesëtar i shtypit.

19 Nëse The Human Right Watch e ka ditur këtë informacione
20 tetor, nëntor të 1998, ju duhet vetë të kishit pasur dyshime
21 në qoftë se në të vërtetë z. Dobricic ka qenë gazetar në
22 momentin që është ndaluar nga UÇK-ja, kështu?

23 PË. Me "këtë informacion" çfarë doni të thoni saktësisht?

24 PY. Bazuar në këtë informacion, ju vetë duhet të kishit
25 dyshime, duhet t'ju kishin lindur dyshime a ka qenë vërtetë

1 Dobricic i përfshirë në gazetari kur është ndaluar nga UÇK-ja?

2 PË. Duhet të ishte, duhet ta kishim marrë të tërë si çështje,
3 duhet ta kishim kuptuar të tërë. Ne kjo është një kumtesë e
4 policisë e drejtorisë së policisë

5 PY. Mirë po e bëj pyetjen ndryshe. Në qoftë se juve do e
6 dinit në tetor të 1998, që z. Dobricic ka qenë i përfshirë në
7 krime lufte në Kroaci, duke përdorur kredencialet e Tanjugut,
8 a nuk do të mendonit ju në fakt që ai do kishte qenë
9 pjesëmarrës në konfliktin në Kosovë?

10 PË. Duhet parë në dy forma kjo pyetje. E para njëherë është
11 dijenia nëse do e merrnim parasysh në analizën tonë krimet e
12 pretenduara që ka kryer ky person tjetër. Edhe gjithashtu
13 kritika që kemi bërë ne këtu në këtë rast ishte fokusuar në
14 faktin a ka pasur një proces të rregullt ligjor, a ka pasur
15 apo s'ka pasur fare proces të rregullt ligjor. Nëse do kishte
16 prova që ndonjë prej këtyre personave a ka kryer vepra penale
17 në Kosovë apo gjetkë, kjo atëherë do të ketë dalë në gjykimin
18 që pretendohet se i është bërë.

19 PY. Po kjo rrit probabilitetin, që z. Dobricic me
20 kredencialet e Tanjugut, i pranishëm në Kosovë, pasi e ka bërë
21 këtë i përfshirë në krime lufte, pra, ajo që dua të them është
22 probabiliteti është shumë i lartë që ky person të ketë qenë i
23 përfshirë në konflikt në Kosovë?

24 PË. Kjo mund, duhet të ketë dalë në gjykimin që mund ose mund
25 të mos ketë ndodhur.

1 PY. Gjykatësi Barthe ju bëri disa pyetje lidhur me takimin që
2 keni pasur me z. Limaj edhe z. Thaçi - dhe i referohem faqes
3 7569, rreshtat 18 deri në 25 - dhe ju u përgjigjët se z. Thaçi
4 ishte personi që fliste me më shumë autoritet. Ju kujtohet?

5 PË. Po.

6 PY. Fakt është që z. Thaçi u prezantua si zëdhënësi i
7 drejtorisë politike, a s'të tha kështu?

8 PË. Me sa më kujtohet mua dhe unë në dëshminë time po them ai
9 u prezantua si shefi i drejtorisë politike.

10 PY. Dhe ju drejtorinë politike e kuptuat si një organ apo si
11 një drejtori që në fakt komunikonte me ndërkombëtarët, apo jo?

12 PË. Mendova se ishte pjesë e detyrimit apo përgjegjësive të
13 tyre, po nuk e kuptova tërësisht çfarë përgjegjësish kishin.

14 PY. Por ai nuk ishte ushtarak, nuk ishte personi ushtarak në
15 zyrë? Ai ishte më shumë nga ana politike?

16 PË. Kështu u prezantua.

17 PY. Edhe ai s'ishte as jurist. Ju dëshmuat që pjesën e
18 juridike e mbulonte Limaj, kështu?

19 PË. E saktë.

20 PY. Pra, ai po fliste si një person politik me sa kuptuat ju?

21 PË. Bazuar në prezantimin apo në mënyrë sesi u prezantua unë
22 të paktën kështu e kuptova asokohe, po.

23 PY. Atëherë shohim provën materiale 378.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Përpara se të bëj pyetjen. 375, më
25 falni.

1 PY. Është njoftimi për shtyp i The Human Right Watch të cilin
2 keni lëshuar ju. I hedhim një sy. Ky është njoftim për shtyp i
3 The Human Right Watch.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Shkojmë në paragrafin e duhur. Duhet
5 të jetë paragrafi i tretë.

6 PY. Thuhet, sipas informatave që keni pasur ju, që këta
7 persona u deklaruan të humbur më 18 tetor. E shihni këtë?

8 Tani shohim provën materiale P378. Do të flasim dhe për
9 këtë pak më vonë, por paraprakisht dua që ta tregoj në mënyrë
10 që të shtroj pyetjen.

11 Ky është një artikull që ka dalë më 1 nëntor të 1998
12 rreth nëntë ditë para se të uleshit me z. Thaçi dhe z. Limaj
13 dhe këtu flitet për gjykatën ushtarake. Këtu thuhet që gjykimi
14 u krye më 30 shtator 1998. E shihni këtë?

15 Po jua lexoj. Unë po jua lexoj:

16 "Gjykata Ushtarake Drejtorisë së Drejtësisë së Shtabi i
17 Përgjithshëm të UÇK-së në bazë të kërkesës së Prokurorisë
18 Ushtarake dhe në përputhje me normat e saj të punës, në
19 gjykimin e kryer më datë 30 shtator 1998 kundër të pandehurve,
20 kundër Radosevic dhe Dobricic".

21 Dhe vazhdon pastaj. Thuhet që gjykimi është mbajtur, pra,
22 në 30 shtator 1998.

23 Këtu është fakt, ju e dini vetë këtë, e keni si fakt
24 sepse e keni vendosur në njoftimin tuaj për shtyp, P375, që
25 këta persona në fakt nuk u deklaruan të humbur deri më 18

1 tetor, kështu?

2 PË. Kështu.

3 PY. Pra, ky njoftim për shtyp ka informacion të plotë për një
4 nga elementët më të rëndësishëm që është ky, kur janë mbajtur
5 të ndaluar këta persona?

6 PË. Përmendet gjykimi, po.

7 PY. Po, z. Abrahams, ju e dini që gjykimi nuk mund të jetë
8 mbajtur në 30 shtator në qoftë se këta persona, sipas
9 njoftimit tuaj për shtyp, janë deklaruar të humbur pas 18
10 tetorit?

11 PË. Supozoj se është e saktë. Do duhet ta shoh më me
12 vëmendje. Nuk e di me siguri.

13 PY. Po vetë njoftimi juaj për shtyp thotë që e keni marrë
14 informacion nga Tanjugu që këta persona u deklaruan të humbur
15 më 18 tetor, kështu?

16 PË. Më duhet ta shoh.

17 PY. Po e shohim. S'ka problem sa herë të duash. Është prova
18 materiale P375. Lirisht sa herë të doni. Është njoftimi juaj
19 për shtyp. Është i 24 tetorit. Po ju lexoj paragrafin që thotë
20 "Nebojsa Radosevic" flitet për këta persona që janë deklaruar
21 të humbur më 18 tetor.

22 PË. Data e saktë është. Po më ngatërrove kur the sipas
23 Tanjugut u deklaruan të humbur më 18 tetor dhe nuk mu kujtua
24 që të ketë qenë Tanjugu apo të jetë qenë i përfshirë burimi i
25 informacionit në këtë.

1 PY. Më fal. Nuk do doja t'ju ndërprisja. Po ju pajtoheni që
2 Tanjugu tha që ata kanë humbur më 18 tetor?

3 PË. Mendoj se -- okej, ky është ndryshim shumë i vogël po ju
4 thatë sipas Tanjugut, këtu u ngatërrova, po data është 18
5 tetor.

6 PY. Në rregull. Tani shohim provën materiale P378. Kemi një
7 gjykim që është kryer fakt dhe kjo thuhet në provën materiale
8 P378, 19 ditë përpara kësaj edhe supozohet që nuk është bërë
9 gjykimi ditën që u ndaluan apo jo?

10 PË. Në qoftë se informacioni që kemi marrë është i saktë.

11 PY. Sa i takon këtij informacioni është komplet gabim.

12 PË. Cili informacion?

13 PY. Informacioni më i rëndësishëm për ju ishte kur u mbajtën
14 të ndaluar këta persona?

15 PË. Po unë s'kam nga ta di këtë. Unë s'e di. Nuk e di në
16 qoftë se dhe ky tekst është i saktë.

17 PY. Vazhdojmë. Ky është një dokument që përmend, është një
18 dokument që thuhet që gjykata ushtarake e drejtësisë ka bërë
19 gjykimin dhe të njëjtën kohë z. Thaçi u ka treguar që po
20 ngrinin strukturat civile dhe se kërkohej pak kohë për t'u
21 krijuar këto struktura civile apo jo?

22 PË. Të dy bashkëbiseduesit tanë folën për vështirësitë sa u
23 takon krijimit të strukturave qofshin këto civile apo
24 ushtarake në mes të një konflikti të armatosur.

25 PY. Po personi që ka folur për krijimin e strukturave civile

1 dhe unë kam transkriptin që e vërteton këtë, ka qenë z. Thaçi,
2 apo jo?

3 PË. Nuk është nevoja të shohim transkriptin, po padyshim foli
4 për vështirësitë që po ndeshnin për krijimin e strukturave
5 civile dhe mekanizmave të duhur.

6 PY. Pra, jemi në një situatë që është bërë një gjykim,
7 supozohet ku këta persona as nuk ishin ndaluar ende dhe kjo
8 është bërë nga gjykata ushtarake sipas njoftimit për shtyp apo
9 kësaj komunikate she kjo ka qenë njësi ushtarake, ndërkohë
10 Thaçi ju flet për strukturat civile dhe se kërkohej kohë që të
11 krijoheshin strukturat civile.

12 Për ju ishte e qartë para, gjatë apo pas situatës pas
13 faktit që askush se kishte të qartë se çfarë po ndodhte?

14 PË. Okej. Kemi dy pjesë mohuese. S'e kisha të qartë. Unë po
15 merrja informacione, po botoja materiale që na jepnin. Unë nuk
16 mund të them nëse dokumentet janë të sakta. Unë këtë nuk e di.
17 Dhe nuk mund të them në dëshminë time që janë.

18 PY. Po i keni kushtuar rëndësi këtyre komunikatave?

19 PË. Ishin pjesë e punës tonë.

20 PY. Pra, u kushtonit rëndësi këtyre komunikatave qoftë para
21 takimit apo pas takimit, apo jo?

22 PË. Më duket se dhashë dëshmi javën e kaluar ku ju thashë që
23 nuk më kujtohet ta kem parë këtë para takimit.

24 PY. Do flasim dhe për këtë. Po duke marrë parasysh tani
25 informacionet dhe faktit që informacioni është i gabuar dhe

1 gjithashtu duke marrë parasysh që z. Thaçi ka folur për
2 krijimin e strukturave civile dhe ky artikull flet për
3 struktura ushtarake, a nuk pajtoheni ju me mua, që ajo që po
4 bënte z. Thaçi si përfaqësues politik ishte thjesht që po
5 përpiqej sa më mirë që të mundej të përfaqësonte UÇK-në para
6 komunitetit ndërkombëtarë apo të krijonte strukturat e UÇK-së
7 sa më mirë për komunitetin ndërkombëtar?

8 PË. Sigurisht që ai po përpiqej të bënte të pamundurën sa i
9 takon dhe komunitetit ndërkombëtar sepse ajo që përpiqej që të
10 bënte komuniteti ndërkombëtar ishte shumë e rëndësishme.

11 PY. Por ama fakt është, që ju nuk e dini me siguri, në qoftë
12 se ai e dinte se cila çështje, se cila gjykatë e kishte
13 trajtuar?

14 PË. Është e vërtetë nuk mund ta them me siguri. Mund t'ju
15 them vetëm çfarë më tha në takim.

16 PY. Mirë. Ndryshojmë pak fare temë dhe flasim për një pyetje
17 të Gjykatësit Barthe, ne para, biles para se të bëjmë këtë ju
18 i tha Gjykatësit Barthe për një takim që keni pasur në gusht,
19 thatë që nuk patëm më kontakt me z. Thaçi pasi na dha
20 raportin, kështu?

21 PË. Kështu

22 PY. A i përmendët --

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Shohim provën materiale P376 në
24 ekran. Pra, prova materiale P376. Shohim provën materiale.

25 PY. Dua ta shohim për të dhënë një ide se për çfarë është

1 pyetja.

2 A ju kujtohet kjo letra që keni dërguar më 2 dhjetor të
3 1998?

4 PË. Po, më kujtohet.

5 PY. Gjatë takimit me z. Thaçi në prill të 1998, a e pyete
6 ndonjëherë a e mori konkretisht ai këtë letër?

7 Jo, më fal, jo prill, gusht doja të thoja, në gusht të
8 1999, kur shkove t'i jepje një kopje të raportit, a e pyete a
9 e kishte marrë ndonjëherë këtë letër ai të 2 dhjetorit 1998?

10 PË. Nuk më kujtohet ja kam bërë këtë pyetje.

11 PY. Po kjo duhet të kishte qenë e rëndësishme për ju të
12 kuptonit nëse ishte marrë apo jo letra.

13 PË. Më kujtohet që folëm për takimin e nëntorit, është krejt
14 normale në një bisedë mes personave kur thua "Oh sa mirë që po
15 takohemi prapë në rrethana të ndryshme", megjithatë nuk më
16 kujtohet nëse folëm konkretisht për këtë letër.

17 PY. Letra ka datën 2 dhjetor 1998. A e dinit ju që z. Thaçi
18 ishte larguar në mes të nëntorit dhe nuk është kthyer në
19 Kosovë deri në mars të 1999?

20 PË. Për cilat data e keni fjalën?

21 PË. A e dini ju që z. Thaçi është larguar nga Kosova në mes
22 të nëntorit, mesi, fundi nëntorit dhe është kthyer në Kosovë
23 diku nga marsi i 1999? A e dini ju këtë gjë?

24 PË. Nuk e di çfarë lëvizjesh bënte aso kohe.

25 PY. Pra, ju shkruat këtë letër dhe nuk u përpoqët të

1 verifikonit nëse e kishte marrë konkretisht z. Thaçi këtë
2 letër?

3 PË. Ne dërguam letrën. Nuk morëm përgjigje dhe kaq ishte
4 komunikimi.

5 PY. Pyetjen e kisha shumë të thjeshtë. Ju nuk morët asnjë
6 masë të mëtejshme pasi dërguat letrën për të garantuar që z.
7 Thaçi ta kishte marrë këtë letër?

8 PË. Jo, me sa më kujtohet.

9 PY. Tani të shohim, të flasim për pyetjet e Gjykatësit Barthe
10 sa i takon takimit të gushtit 1999. Ju kërkoj ndjesë në qoftë
11 se ndonjëherë datat i them gabim.

12 PË. Ka shumë data.

13 PY. Po, po ka shumë data. Është faqja 7571, rreshti 4 deri në
14 8 dhe pastaj rreshti 12 dhe 15. Gjykatësi Barthe ju pyeti në
15 qoftë se takimi me z. Thaçi në gusht të 1999 u mbajt në gjuhën
16 shqipe apo angleze dhe ju u përgjigjët se ju kujtohet se
17 takimi është mbajtur kryesisht në gjuhën shqipe. Ju kujtohet?

18 PË. Po, më kujtohet.

19 PY. Po ashtu ju i thatë Gjykatësit Barthe që vetëm ti dhe z.
20 Thaçi keni qenë të pranishëm në këtë takim. Ju kujtohet?

21 PË. Po, më kujtohet.

22 PY. Të martën në faqen 7298, rreshti 2 i transkriptit, thatë
23 që flisni "deri në një farë mase në shqip" dhe mbyll citimin.
24 Ju kujtohet?

25 PË. Po, më kujtohet.

1 PY. Në qoftë se takimi është mbajtur kryesisht në gjuhën
2 shqipe dhe ju s'e flisni rrjedhshëm shqipen, ju nuk mund jeni
3 i sigurt që s'ka pasur keqkuptime gjatë takimit mes jush, apo
4 jo?

5 PË. Sa i takon aftësive të mia në gjuhën shqipe, unë kam
6 dhënë shumë intervista në radio-televizione shqiptare, kështu
7 që besoj që aftësitë e mia për sa i takon shqipes mund të
8 gjykohen. Sepse intervistat e mia janë publike.

9 Lidhur me pyetjen që më bërë në takimin e mbajtur, sipas
10 mendimit tim, unë kam kuptuar thelbin e përgjigjeve të tij.
11 Kam kuptuar mesazhet kryesore dhe e njëjta gjë ka ndodhur edhe
12 për bashkëbiseduesin tjetër.

13 PY. Z. Abrahamas, ju thatë që ju flisni deri në një masë të
14 caktuar, por "nuk jeni i rrjedhshëm" në gjuhën shqipe apo jo?
15 A keni thënë kështu në dëshminë tuaj, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Domethënë, e keni pranuar vetë që nuk jeni i rrjedhshëm
18 nuk keni njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Besoj që ju e dini që sa i takon aftësisë për të folur
21 dhe për të kuptuar anglisht ka qenë shumë bazike për z. Thaçi?

22 PË. E keni fjalën tani apo atëherë?

23 PY. E kam fjalën për kohën atëherë.

24 PË. Mund të them që komunikimi në anglisht në atë kohë nuk
25 është se më ka lënë ndonjë përshtypje.

1 PY. Në rregull atëherë. Unë mund të them që bashkëbiseduesi
2 juaj nuk fliste anglisht, ndërkohë që niveli i shqipes tuaj
3 ishte ai që ju sapo thatë dhe ju jeni i sigurt që nuk ka pasur
4 keqkuptime në atë takim?

5 Z. TIEGER: [Përkthim] E kundërshtojmë. Është pyetje që u
6 bë dhe e mori përgjigjen.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

8 Z. KEHOE: [Përkthim]

9 PY. Në rregull. Vazhdojmë me komunikatat e tjera. Do të doja
10 që të kalojmë tek faqja 7576, rreshtat 23 deri në 25. Në
11 transkriptin e të enjtes juve i thatë Gjykatësit Mettraux që
12 ju i jepnit "një vlerë të madhe këtyre komunikatave sepse
13 prodhoheshin nga strukturat zyrtare, nga grupi i armatosur në
14 këtë rast". Nuk e di në qoftë se e mbani mend këtë përgjigje
15 që i dhatë Gjykatësit Mettraux në pyetjen që u bëri ai?

16 PË. Po, më kujtohet.

17 PY. Tani le të shikojmë provën materiale 378. Ta vendosim
18 përsëri këtë provë materiale në ekran. Do ju pyes për një
19 tjetër temë kësaj radhe. Përsëri kjo është deklarata e bërë
20 nga UÇK-ja, të paktën nëntë apo dhjetë ditë përpara sesa të
21 takoheshit me z. Limaj dhe z. Thaçi dhe këtu thuhet që të
22 ashtuquajturit gazetarë ishin dënuar, ishin shpallur fajtorë
23 dhe ishin transferuar në Burgun numër 7. Ky është një artikull
24 i cili është botuar nga Arta. E shikoni në fillim të ekranit?

25 PË. Po, e shoh.

1 PY. Na e the dhe sot paradite dhe e kemi thënë edhe javën që
2 shkoi në faqen e transkriptit 1734, se nuk e keni parë këtë
3 raport më përpara deri në dhjetor 1998. E mbani mend ta keni
4 thënë këtë?

5 PË. Jo, nuk më kujtohet, por ju besoj kur e thoni këtë gjë.

6 PY. Ju nuk e keni parë këtë komunikatë të UÇK-së përpara sesa
7 të takoheshit me z. Thaçi dhe Limaj edhe pse subjekti i
8 komunikimit ose tema e komunikimit ishte e njëjta temë,
9 ndërmjet të tjerash, që të kërkonit një takim me UÇK-në duke
10 pyetur ndër të tjera dhe për gazetarët, apo jo?

11 PË. Qëllimi i takimit ishte shumëplanësh, nuk ishte vetëm
12 thjesht i përqendruar te gazetarët. Ndërkohë që ne diskutuam
13 temën e z. Radosevic dhe z. Dobricic për shkak të faktit që
14 kishte shumë vëmendje dhe interes lidhur me të dhe ishte një
15 çështje shqetësuese dhe duke përdorur këtë rast ne mund të
16 theksonim pika të tjera të cilat ishin të rëndësishme për ne
17 dhe që lidheshin me ndalimin e njerëzve apo me abuzimin e
18 mundshëm në ndalim. Nuk ishte e vetmja temë kjo.

19 Në mënyrë të tillë që ne të mund të parashtronim të
20 gjithë këndvështrimin tonë për sa i takon abuzimeve nga të
21 gjitha palët, përfshirë edhe atë serbe dhe jugosllave, ne i
22 kërkuam bashkëfolësve atëherë që: Në qoftë se kishin
23 informacion për krime lufte të pretenduara nga forcat serbe
24 dhe jugosllave, ishim të hapur që ta merrnim këtë lloj
25 informacioni prej tare po ashtu edhe pretendime sa i takon

1 sjelljes së tyre në raport me të drejtën humanitare
2 ndërkombëtare.

3 Domethënë nuk është se ishim në takim vetëm për të
4 diskutuar për gazetarët.

5 PY. Ju dhatë dëshmi këtu para disa ditësh, në përgjigje të
6 pyetjeve të bëra nga Prokurori, nga ekipet e mbrojtjes të të
7 akuzuarëve, nga Trupi Gjykses që ky takim, pra, takimi i 10
8 nëntorit 1998, kishte të bënte me këta dy gazetarë të
9 pretenduar?

10 PË. Po.

11 PY. Sapo na thatë që kjo ishte një çështje që kishte tërhequr
12 shumë vëmendje asokohe, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe që kishte shumë shqetësim në atë kohë lidhur me këtë
15 temë?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe kjo është një prej arsyeve se pse e ngritët këtë temë
18 në takimin që ju patët me strukturat e UÇK-së?

19 PË. Po, e saktë është kjo.

20 PY. Duke marrë parasysh faktin që nuk kishit marrë apo nuk e
21 kujtoni që e keni parë këtë komunikatë përpara sesa të bëhej
22 ky takim, madje edhe përpara sesa të bënit botimin e raportit
23 The Human Right Watch, të paktën kjo komunikatë, nuk ishte i
24 takon që nuk ishte e rëndësishme për juve, kështu?

25 PË. Jo. Ajo çfarëdo të thotë kjo është që nuk jap dot dëshmi

1 lidhur me të. Nuk më kujtohet që e kam parë atëherë.

2 PY. Nuk e keni parë as atëherë dhe nuk e keni parë edhe kur
3 bëtë botimin tuaj, në fund të dhjetorit, në mos gabohem dhe
4 pastaj kur nxorët një tjetër botim në gusht të 1999, kështu që
5 nuk e keni parë asnjëherë, këtë po thoni?

6 PË. Do më duhet të shoh dhe një herë, megjithatë kam
7 përshtypjen që e kemi përmendur diku në një prej botimeve tona
8 e kemi përmendur diku. Ju kërkoj ndjesë që po i ngatërroj të
9 dyja.

10 PY. Tani që je përpara nesh, a e ke idenë se ku e keni
11 përmendur këtë komunikatë?

12 PË. Kemi përmendur Burgun numër 7 dhe kam përshtypjen që
13 mbase mund ta kemi përmendur, megjithatë nuk më kujtohet
14 ekzaktësisht se ku është përmendur.

15 PY. Pra, i takon që ju informacionin për Burgun numër 7 e
16 keni marrë në një pikë të caktuar kohe nga kjo komunikatë,
17 kështu?

18 PË. Nuk më kujtohet kjo.

19 PY. Të ndërrojmë pak temë, do bëjmë disa pyetje që kanë të
20 bëjnë me Adem Demaçin dhe besoj ju kujtohet që Gjykatësi
21 Mettraux ju bëri disa pyetje për Adem Demaçin. Ju kujtohet?

22 PË. Po.

23 PY. A ju kujtohet që Gjykatësi Mettraux ju pyeti në qoftë se
24 kishit dëgjuar për lirimin e një polici serb me emrin Goran
25 Zbilic nga burgu i UÇK-së dhe a ju kujtohet se çfarë përgjigje

1 i thatë? A ju kujtohet?

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe se për procesverbal për kjo
3 është në faqen 7579, rreshtat 2 deri në 6.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Jo, nuk e dija.

5 Z. KEHOE: [Përkthim]

6 PY. Dhe mbase dhe mënyra sesi e formuloj unë është ndonjëherë
7 e vështirë për të dhënë përgjigjen e duhur. Ju kërkoj ndjesë,
8 po e kuptojmë njeri-tjetrin besoj. Pra, juve ju kujtohet çfarë
9 përgjigje i dhatë Gjykatësit Mettraux, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Gjykatësi Mettraux më pas vazhdoi dhe ju lexoi një pjesë
12 të një transkripti të një konference për shtyp ku flitej për
13 çështjen ose rastin Zbilic dhe këtu citoj: "Megjithatë, nuk
14 jam -- nuk kam të drejtë që të ndërhyj me këtë çështje. Unë
15 mund të ndërhyj vetëm si një person humanitar dhe mund të bëj
16 propozime të mira", këtu fletë Demaçi, "Siç e dini kjo nuk
17 varet nga unë".

18 Më duroni një çast ju lutem. Pastaj Gjykatësi Mettraux ju
19 pyet a është kjo në përputhje me atë çfarë ju ka treguar
20 Demaçi kur jeni takuar me të që ai nuk kishte kompetenca apo
21 pushtet vendimmarrës sa i takon fatit të këtyre individëve.
22 Përgjigja juaj dhe për procesverbal ky është në faqen 7579,
23 rreshti 29 [sipas përkthimit] deri në faqen 7580, rreshti 5.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
25 çaktivizuar].

1 Z. KEHOE: [Përkthim]

2 PY. Përgjigja juaj është kjo:

3 "Po, kjo është në përputhje. Jam larguar nga takimi me z.
4 Demaçi kur diskutuam këtë rast, me përshtypjen që ai nuk
5 kishte kompetencë për të liruar njerëzit".

6 Z. TIEGER: [Përkthim] Thjesht dua të them ndërkohë që po
7 mundohem që ta ndjek linjën e pyetjeve të Avokatit, mendoj që
8 citimi përmban një pasaktësi, sugjeron që ky koment ka të bëjë
9 me ndalimin dhe me lirimin e z. Zbilic dhe me sa më kujtohet
10 mua, në fakt bëhet fjalë për lirimin e z. Dobrocic dhe
11 Radosevic.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na e sqaroni
13 pak, z. Kehoe.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Kjo referencë ka të bëjë me z.
15 Zbilic dhe të njëjtin gjë ose të ngjashme ka thënë gjithashtu
16 edhe sa i takon dy gazetarëve.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të presim
18 një çast për të parë nëse mund të gjejmë referencën për të
19 qenë tërësisht të qartë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është në faqen 3 të
21 dokumentit 064127-11-26789-TR-ET E rishikuar, ora është 10:53.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Gjykatës thjesht dëshiroj t'ju them
23 që ka një lloj përzierje për shkak të pyetjeve që po bëjmë,
24 gjithsesi për sa i takon arsyes sepse po i bëj këto pyetje nuk
25 është se ka ndonjë dallim.

1 Pra, diskutimi filloi me Zbilic, ai thotë që nuk e dinte
2 dhe pastaj në fakt, këtu Prokurori ka 100 për qind të drejtë,
3 vazhdohet më tej me diskutimin rreth dy gazetarëve. Në fakt
4 Gjykatës, në qoftë se do shikoni transkriptin që lidhet me
5 pyetjet e Gjykatësit Mettraux, fatkeqësisht është transkripti
6 i përkohshëm, atëherë dua që të shikoni në rreshtin 4 dhe aty
7 ka një pyetje, pra, domethënë:

8 "Dua të shikoni në faqen 3 në kohën 10:53. Ka një pyetje
9 nga një gazetar që thotë që:

10 "Flitet jo vetëm për Dobricic dhe gazetarin tjetër, po
11 flitet për të gjithë ata, jo vetëm për dy persona".

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
13 pyetje z. Mettraux?

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull

16 PY. Ti kthehemi prapë temës. Pra, Gjykatësi Mettraux ju lexoi
17 komentet e bëra nga Demaçi. Dhe citoj që:

18 "Gjithsesi unë kam të drejtë që të ndërhyjë në çështje të
19 tilla. Unë mund të ndërhyjë vetëm si humanitar dhe mund të
20 bëjë propozime të mira. Por ju e di shumë mirë që kjo nuk
21 varet nga unë".

22 Më pas z. Mettraux ju pyeti a është në përputhje kjo me
23 atë çfarë ju tregoi z. Demaçi në takimin me të që ai nuk
24 kishte kompetenca vendimmarrëse lidhur me këta individë.

25 Përgjigja që ti jep - dhe për procesverbal kjo është përgjigja

1 e dhënë në faqen 7579, rreshti 21 deri në faqen 7580, rreshti

2 5. Ti thua:

3 "Kjo është në pajtim me atë çfarë diskutuam. Unë u
4 largova nga takimi me z. Demaçit ku u diskutuan çështjet në
5 fjalë dhe përshtypja ime ishte e qartë që ai nuk kishte
6 kompetencë për t'i liruar këta njerëz".

7 A ju kujtohet kjo që keni thënë javën e shkuar?

8 PË. Po.

9 PY. Tani, le të diskutojmë pak lidhur me kompetencën ose
10 pushtetin e z. Demaçi në rastin e z. Zbilic, ku vazhdon
11 Gjykatësi Mettraux që t'ju bëj pyetjen se çfarë, se në qoftë
12 se përshkrimi që ai jep është në përputhje me atë çfarë ju ju
13 ngeli pasi u takuat me z. Demaçi.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Për procesverbal është dokument
15 DHT01486. Do të përqendrohem tek faqja DHT01488.

16 Përpara sesa ta paraqesim në ekran dëshiroj t'ju tregoj
17 anëtarëve të Trupit Gjykues që kur është parashtruar është
18 parashtruar si dokument konfidencial, po nuk jam i sigurt në
19 qoftë se zbatohet përsëri ky lloj klasifikimi për dokumentin
20 sepse është një dokument i cili është përdorur në çështjen
21 kundër z. Mustafa. Për të qenë të kujdesshëm do kërkoja që të
22 mos paraqitet në ekran, megjithatë do jua lë në dorë kolegëve
23 të Prokurorisë për të vendosur.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
25 kundërshtim për sa i takon paraqitjes së këtij dokumenti

1 konkret?

2 Z. TIEGER: [Përkthim] Jo, i nderuar Kryegjykatës.

3 Z. KEHOE: [Përkthim]

4 PY. Tani kur flas për këtë dokument e kam fjalën për
5 paragrafin 12 konkretisht. Në paragrafin 12 thuhet, është një
6 përmbledhje e Prokurorisë të dëshmisë së komandantit të zonës
7 Rustem Mustafa, i njohur ndryshe si komandant Remi. Prokuroria
8 ka thënë si më poshtë lidhur me të, e thashë edhe njëherë
9 bëhet fjalë për paragrafin 12.

10 "Dëshmitari", dëshmitari është Remi, "do të dëshmojë
11 gjithashtu edhe për ndalimin e Zoran Zbilic, anëtar i
12 shërbimit të sigurisë serbe në nëntor të 1998 në Llapashticë.
13 Shtabi i Përgjithshëm u informua për ndalimin e tij dhe më pas
14 la 04746", që është z. Remi, "të vendoste se çfarë të bënte me
15 të. Më pas Adem Demaçi ndërhyri për lirimin e Zbilic, pasi
16 William Walker dhe Shaun Byenes nga OSBE-ja u interesuan për
17 këtë rast. Dhe fjala e Demaçit kishte shumë peshë në atë kohë
18 dhe për pasojë [Remi apo Rustem Mustafa] vendosi që ta lironte
19 këtë të ndaluar".

20 Përveç këtij komenti të Prokurorisë, sa i takon peshën që
21 kishte Demaçi domethënë, që Demaçi kishte kaq peshë për
22 lirimin e të ndaluarve dhe si rezultat Remi e liroi të
23 ndaluarin dhe duke pasur parasysh atë çfarë ngriti z. Mettraux
24 në pyetjet e veta dëshiroj që t'ju lexoj atë çfarë ka dëshmuar
25 Remi në këtë sallë gjyqi.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Për procesverbal, është transkripti
2 i datë 13 korrik 2023, faqja 5614, rreshtat 11 deri në 14.

3 Z. TIEGER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, para se të
4 vazhdojmë më tej, ju kërkoj ndjesë Avokat. Po për arsye
5 saktësie, ky nuk është komenti i Prokurorisë sesa peshë kishte
6 fjala e z. Demaçi apo jo, është thjesht një përmbledhje e asaj
7 çfarë pritej që të thuhej prej z. Mustafa dhe janë dy gjëra të
8 ndryshme këto.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E saktë kjo.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Në masën që nuk është parë siç duhet
11 ju kërkoj ndjesë.

12 PY. Atëherë, këtu thuhet, pra, Remi thotë që fjala e Demaçit
13 kishte shumë peshë. Atëherë le të shohim se çfarë ka dhënë
14 dëshmi, çfarë ka dëshmuar ai.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Edhe një herë për procesverbal është
16 faqja 5614, 13 korrik, rreshtat 11 deri në 14.

17 PY. Më konkretisht po flasim për lirimin e Zbiliqit këtu.

18 "PY. A mund të na shpjegoni ju lutem se çfarë përfshirje
19 ka pasur Adem Demaçi në lirimin?

20 "PË. Adem Demaçi ishte autoritet për ne dhe ne e
21 respektonim fjalën e tij dhe për pasojë ne e liruem personin".

22 A është kjo në përputhje me atë çfarë ju tregoi ju z.
23 Demaçi kur u takuat me të?

24 PË. Jo.

25 PY. Gjykatësi Mettraux ju tregoi gjithashtu edhe një pjesë të

1 konferencës për shtyp, e kam fjalën për konferencën për shtyp
2 të Demaçit dhe Rugovës për të cilën po fliste z. Mettraux. Ku
3 Demaçi pretendon se i bëri thirrje Shtabit të Përgjithshëm për
4 lirim të z. Zbilic. A ju kujtohet kjo?

5 PË. Po.

6 PY. Le ta shohim pak, sikurse mund ta shikoni. Nga
7 përmbledhja e dëshmisë së ZPS-së, vendimin për ta liruar
8 Zbilic e mori Remi, apo jo?

9 PË. Nuk shikoj asgjë në ekran.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lutem, a mund ta paraqisni edhe
11 një herë këtë dokument në ekran.

12 PY. Shihni pak rreshtin e fundit. Në këtë rresht, në këtë
13 përmbledhje pra, është Remi që thotë që ai vetë e mori
14 vendimin që ta lironte të ndaluarin, nuk e mori Shtabi i
15 Përgjithshëm, ishte Remi vetë që e mori këtë vendim. E shikon
16 këtë gjë, apo jo?

17 PË. E shoh.

18 PY. A është kjo në përputhje me atë çfarë kishe kuptuar ti që
19 bënte z. Demaçi në kuptimin e rolit dhe pozicionin e vetë?

20 PË. Po.

21 PY. Pra, që z. Demaçi i tregonte një prej komandantëve të
22 zonës operative të Llapit dhe ky komandant vetë në dëshminë
23 përpara Trupit Gjykses thotë që i ka respektuar fjalët e tij,
24 të Demaçit pra dhe ka liruar Zbilic?

25 PË. Unë nuk kam informacion sa i takon marrëdhënies midis z.

1 Demaçi dhe z. Mustafa. Megjithatë ajo çfarë dua të theksoj
2 këtu është se mbështetur në tekstin që kemi përpara, z.
3 Mustafa ka pasur goxha respekt, e shikonte me shumë
4 konsideratë z. Demaçi që e ka marrë parasysh kërkesën e tij
5 dhe pastaj vetë ka marrë përsipër që ta lirojë të burgosurin
6 në fjalë. Sipas mendimit tim, kjo është në përputhje, në
7 kuptimin, që reputacioni moral ose rëndësia morale e z. Demaçi
8 ishte e pranishme për të bërë ndërhyrje dhe mbështetur në
9 ndërhyrjet që bënte z. Demaçi vendosnin pastaj anëtarët e UÇK-
10 së.

11 PY. Le të vazhdojmë, zotëri, kemi dhe ca çështje të tjera për
12 të mbuluar. Gjykatësi Mettraux ju tregoi gjithashtu dhe një
13 pjesë të konferencës për shtyp ku Demaçi tha që "nuk varet nga
14 unë, nuk vendos unë për çështjet e ndalimit". Ju kujtohet kjo?
15 PË. Po.

16 PY. Po edhe kjo ka qenë e ngjashme me atë çfarë tha z. Thaçi,
17 apo jo, kur z. Thaçi ju tha - dhe për procesverbal e kam
18 fjalën për faqen 7523. Kur thotë që do ishte e papërshtatshme
19 që të ndërhyhej me autoritetet gjyqësore civile, domethënë, në
20 thelb ai ka thënë të njëjtat gjëra siç ka thënë edhe z.
21 Demaçi, apo jo?

22 PË. Z. Thaçi, tha që duhej që të respektohej pavarësia e
23 gjyqësorit. Nuk duhej të ndërhyhej me gjyqësorin. Dhe se
24 lirimi i hershëm përpara përfundimit të dënimit ishte dhënë,
25 kjo në vetvete në qoftë se do të liroheshin përpara

- 1 përfundimit të dënimit, do të cenonte autoritetin e UÇK-së.
- 2 PY. Domethënë, Thaçi ju ka thënë juve që nuk ndërhyhej ose do
3 ishte e papërshtatshme që të ndërhyhej me procesin gjyqësor.
4 Dhe ai, siç edhe Demaçi, tha që nuk ka autoritet sa i takon
5 ndalimeve, apo jo?
- 6 PË. Ai tha që nuk ndërhynte për shkak të arsyeve që sapo
7 përmende.
- 8 PY. Sepse ishte e papërshtatshme për të për të ndërhyrë,
9 kështu?
- 10 PË. Sepse duhej që respektohej proceset gjyqësore.
- 11 PY. Kjo është në pajtim me atë çfarë ju ka thënë Demaçi, apo
12 jo?
- 13 PË. Pak a shumë e njëjta gjë.
- 14 PY. Po në thelb është e njëjta gjë?
- 15 PË. Sa i takon z. Demaçi, mënyra sesi kuptoj unë qëndrimin e
16 tij ishte që ai nuk kishte kompetencë për të ndërhyrë.
- 17 PY. Po ndërkohë Thaçi, si përfaqësues politik ty të ka thënë
18 që ishte e papërshtatshme për të ndërhyrë apo jo?
- 19 PË. Po, këtë ka thënë z. Thaçi.
- 20 PY. Ju gjithashtu në përgjigjen tuaj ndaj pyetjes së
21 Gjykatësit Mettraux kur u pyetët në qoftë se Demaçi po
22 vepronte nën autorizimin e Shtabit të Përgjithshëm, përgjigja
23 juaj ishte që kjo është në përputhje me ashtu siç e keni
24 kuptuar ju pozicionin e tij. Kjo pasqyrohet në faqen 7581,
25 rreshtat 4 deri në 15. A ju kujtohet?

1 PË. Nuk dua të jem i vështirë, ju kërkoj ndjesë, po nuk më
2 kujtohet.

3 PY. Pra, nuk ju kujtohet që i ke thënë Gjykatësit Mettraux se
4 kur Demaçi po vepronte me autorizimin e UÇK-së, kjo ishte në
5 përputhshmëri ose në pajtime atë çfarë kuptonit ju se çfarë
6 roli kishte Demaçi.

7 Z. TIEGER: [Përkthim] Do parashtroj që në veçanti në këtë
8 rast do ishte shumë e dobishme në qoftë se kolegu im do ishte
9 më konkret lidhur me referencën në mënyrë të tillë që
10 dëshmitari ta ketë të qartë për çfarë e ka fjalën Avokati
11 Kehoe.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Po mundohem që ta kaloj sa më
13 shpejtë prandaj.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se ju ndihmon z.
15 Kehoe, bëhet fjalë për faqen 7 të transkriptit, kjo është
16 pjesa që ju përmendët për konferencën për shtyp dhe
17 transkripti është 7581.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi Mettraux.

19 PY. Pra, në faqen 7, në përkthim, Demaçi thotë:

20 "Jo, unë kam autorizim nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-
21 së".

22 Pyetja që ju bën Gjykatësi Mettraux është që, domethënë,
23 bëhet një pyetje për sa i takon këtij komenti konkret. Pyetja
24 që ju bëhet është:

25 "Në qoftë se kjo është në përputhje me atë çfarë kishit

1 kuptuar ju që Demaçi po vepronte të paktën në këtë kontekst
2 konkret me autorizimin e Shtabit të Përgjithshëm, apo është në
3 kundërshtim me atë çfarë keni kuptuar ju si pozicionin e
4 Demaçit”.

5 Dhe ju thoni:

6 “Jo, nuk është në përputhje me atë çfarë kam kuptuar
7 unë”.

8 Z. TIEGER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo është
9 natyra e kundërshtimit në fakt. Ajo çfarë kërkoj unë është të
10 jepet “konteksti i veçantë, konteksti specifik”. Dhe besoj që
11 mund ta gjejmë këtë në faqen 7851, rreshtat 9 deri në 10 të
12 transkriptit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast ju
14 lutem. Ju lutem na e thoni referencën e qartë, cila është baza
15 e pyetjeve tuaja.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rreshtin 17, Gjykatësi Mettraux,
17 bën këtë citim, që ka të bëjë me z. Demaçi.

18 “Unë kam autorizim nga Shtabi i Përgjithshëm, për të
19 formuar kuvendin, për të formuar qeverinë, për të formuar një
20 grup negociues”.

21 A ju kujtohet kjo pyetje?

22 PË. Po. Më kujtohet.

23 PY. Dhe kur Gjykatësi Mettraux ju pyeti lidhur me këtë pyetje
24 dhe ju tha, pra, në qoftë se ju besonit ose kuptonit rolin e
25 z. Demaçi si me autoritet sa i takon Shtabit të Përgjithshëm,

1 ju thatë po, apo jo?

2 PË. Po. Besoj atëherë dhe besoj se edhe sot e kësaj dite që

3 z. Demaçi, përfaqësimi politik i z. Demaçi në zyrën në

4 Prishtinë nuk do të kishte ndodhur pa autorizimin e Shtabit të

5 Përgjithshëm ose të paktën të UÇK-së në atë kohë.

6 PY. Z. Abrahams, cilët janë individët konkretë në Shtabin e

7 Përgjithshëm të UÇK-së nga ku duhet të merrte autorizim

8 Demaçi?

9 PË. Nuk mund t'i përgjigjem kësaj pyetjeje.

10 PY. Pra, ju po na thoni që kur z. Demaçi thotë që funksionon

11 mbështetur në autorizimin e UÇK-së në përgjigje të pyetjeve që

12 ju bënë z. Mettraux, ju nuk mund të na thoni konkretisht se

13 kush janë individët nga të cilët duhej ta merrte këtë

14 autorizim z. Demaçi apo jo?

15 PË. Unë mund t'ju them se nuk ka mundësi që unë, që ishte e

16 pamundur, domethënë, që ai ndiqte këtë lloj funksioni në

17 Prishtinë në qoftë se do të kishte ndonjë kundërshtim nga

18 ndonjë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm për të luajtur atë

19 rol.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Le të shkojmë tek dokumenti tjetër

21 me numër identifikimi ERN 01167 në faqen 68 në versionin në

22 shqip dhe dokumenti 061168 deri në 061168 në faqen që

23 përfundon me 68 në fund. Do i lutesha Sekretares ta paraqesë

24 në ekran këtë faqe.

25 PY. Z. Abrahams, mund t'i hidhni një sy të shpejtë këtij

1 dokumenti, që është një draft marrëveshje që UÇK-ja dhe FARK-u
2 bien dakord që të shkrihen në një informacion të vetëm. Mban
3 datën 2 nëntor 1998. Ata u pajtuan për të unifikuar një
4 formacion. Dhe kjo ka ndodhur tetë përpara sesa të takoheshit
5 me z. Thaçi dhe z. Limaj.

6 Në qoftë se do shikojmë në fund të faqes thuhet që
7 marrëveshja do të hyjë në fuqi në qoftë se do të bie dakord me
8 të në një takim pasues ku Adem Demaçi do jetë një prej
9 pjesëmarrësve. Pra, sipas këtij dokumenti i takon që Adem
10 Demaçi ishte një person i rëndësishëm për vendosur në qoftë se
11 të konfirmohet marrëveshja për unifikimin e informacioneve
12 ushtarake. A është në pajtim kjo me kuptimin e z. Demaçi prej
13 jush?

14 PË. Po. Unë nuk kam thënë asnjëherë që z. Demaçi nuk është
15 relevant, nuk është i rëndësishëm ose nuk ka influencë,
16 megjithatë unë besoj se kryesisht ai ka pasur rol si
17 përfaqësues publik me ndërkombëtarët, si puna ime, diplomatët
18 dhe publiku shqiptar që kishin goxha respekt për të, kjo nuk
19 do të thotë që ai nuk ka qenë pjesë e bisedave. Ajo çfarë do
20 parashtroja në këtë rast është se negociata e brendshme
21 shqiptare që ai ka bërë dhe ai mund të bënte dhe sigurisht që
22 ka bërë, që ai ka luajtur një rol.

23 PY. Dhe ka luajtur rol dhe në dokument thuhet që ky, që
24 formacionet nuk do të shkrihen deri në momentin kur ai e
25 miraton këtë marrëveshje, kështu?

1 PË. Po.

2 PY. Pra, miratimi ose pëlqimi për shkrirjen e dy pjesëve të
3 UÇK-së dhe FARK-ut, kjo nuk do të thotë që ai ka pasur një rol
4 sa për sy e faqe, apo jo?

5 PË. Unë nuk mendoj që kjo është jo në pajtim me përfaqësimin
6 ose përshkrimin e rolit të tij.

7 PY. Po kur Gjykatësi Mettraux ju bëri pyetje në qoftë se
8 Demaçi kishte vetëm thjesht si figurë, ju nuk thatë këtë gjë
9 thatë gjë tjetër, apo jo?

10 PË. Mendoj se mënyra sesi e kanë formuluar përgjigjen atëherë
11 është në përputhje me këtë që po them tani, në kuptimin që ai
12 ishte figurë e rëndësishme në shoqërinë kosovare por ka pasur
13 ndikim, nuk ka pasur influencë të madhe sa i takon
14 vendimmarrjes dhe sa i takon çështjeve ushtarake. Sipas
15 mendimit tim, ky diskutim ishte një diskutim i brendshëm
16 politik shqiptarë që ka rëndësi sigurie. Nuk po sugjeroj fare
17 që z. Demaçi nuk ka luajtur asnjë rol.

18 PY. Kalojmë tani te një dokument tjetër që është DHT01485, të
19 nderuar Gjykatës, është një dokument të cilin do ta diskutojmë
20 në seancë të mbyllur dhe këtë pas konsultimeve që kemi bërë me
21 palën tjetër. Seancë private, ju kërkoj ndjesë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem të
23 kalojmë në seancë private, Sekretaria.

24 [Seancë private]

25 [Seancë private teksti i fshirë]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 [Vijon] (Seancë private)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 37

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 [Vijon] (Seancë private)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 38

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 [Vijon] (Seancë private)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 39

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kemi kaluar në seancë
20 publike.

21 Z. KEHOE: [Përkthim]

22 PY. Ju keni thënë që në këtë raport për sa i përket veprimeve
23 të UNPROFOR dhe KFOR-it - dhe unë i referohem P379, faqes
24 22573 - përgjegjësia e sulmeve kundër minoriteteve në Kosovë
25 është e vonuar".

1 Ju keni thënë që:

2 "Nga 22 korriku, më pak se 1.800 policë civilë të
3 autorizuar nga Kombet e Bashkuara një numër shumë i vogël
4 është dislokuar, pavarësisht se janë dërguar nga Bosnja.
5 Përveç pavarësisht këtyre përpjekjeve kjo nënkupton dhe e bën
6 të qartë se nuk përmbushen dot të gjitha detyrimet për të
7 siguruar policinë për Kosovën për të ruajtur këtë".

8 Kjo është kritika juaj për UNMIK-un.

9 Po kështu keni thënë në faqen tjetër që:

10 "KFOR-i nuk ka arritur që të arrijë ndalimin e rrëmbimit
11 të romëve dhe të serbëve".

12 Kështu keni thënë?

13 PË. Dakord. Kështu është.

14 PY. Pra, ju keni thënë në atë kohë që kur keni shkuar për të
15 takuar Thaçin që situata ka qenë e pa e UNMIK-ut dhe KFOR-i ka
16 qenë e pamundur për të kontrolluar situatën, keni thënë kështu
17 apo jo?

18 PË. Forcat e NATO-s kanë ardhur të përgatitur për të luftuar
19 sulmet jugosllave dhe serbe. Dhe nuk janë të përgatitur për të
20 ndërhyrë në mënyrë të duhur për të mbështetur civilët nga
21 pikëpamja policore. Dhe kjo ka qenë një nga kritikrat kryesore
22 të organizatave ndërkombëtare. Dështimi i tyre për të
23 përballuar një situatë të parashikueshme.

24 PY. Dhe në qershor, korrik dhe gusht, personi në Kosovë që e
25 ka dënuar këtë dhunë ndaj tyre ka qenë z. Thaçi, apo jo?

1 PË. Po, ka bërë deklarata publike për këtë.

2 PY. Ju keni përmendur Graçko një nga këto, kështu?

3 PË. Po, kështu është.

4 PY. Dhe ju keni thënë, keni paraqitur situatën në qershor ku
5 serbët ishin nga njëra anë e lumit dhe shqiptarët nga ana
6 tjetër dhe kur ishte duke lindur një konflikt. Dhe Hashim
7 Thaçi shkoi atje dhe e zgjidhi këtë situatë, kështu është apo
8 jo?

9 PË. Jo, nuk e di një gjë të tillë.

10 PY. Pra, po e dini sidoqoftë se përveç se ka dënuar dhunën
11 disa herë, Thaçi ishte ai i cili në mënyrë të vazhdueshme ka
12 bërë thirrje për krijimin e një shoqërie shumë etnike dhe ka
13 bërë thirrje që serbët të mos largohen, apo jo?

14 PË. Z. Thaçi, ka bërë deklarata publike të tilla, po.

15 PY. Dhe këtë e ka bërë gjatë gjithë kësaj periudhe kohore
16 edhe në median ndërkombëtare edhe në median vendase. Siç e
17 thatë ju, që të cilën ju siç e thatë e keni analizuar?

18 PË. Po, ka bërë deklarata publike kundër dhunës.

19 PY. Dhe këtë e ka bërë jo vetëm për ndërkombëtarët po e ka
20 bërë edhe brenda vendit, apo jo?

21 PË. Po, besoj se po.

22 PY. Pra, jeni dakord atëherë që ai ishte i vetmi person apo
23 udhëheqës në Kosovë në atë kohë i cili ka dënuar dhunën, është
24 përpjekur për të parandaluar dhunën dhe ka bërë thirrje për
25 krijimin e një shoqërie shumëetnike. Ai është i vetmi që ka

1 bërë këto deklaratat në Kosovë.

2 Z. TIEGER: [Përkthim] Kundërshtime. Kjo është një pyetje
3 përbërëse. A ka mundësi ta bëni pjesë-pjesë?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigjuni
5 si keni mundur.

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Përgjigja është jo, ka bërë
7 deklaratat kundër kësaj dhune, po ka patur shqiptarë të tjerë
8 të Kosovës të cilët e kanë dënuar hakmarrjen, kanë kërkuar
9 respektin e të drejtave të njeriut që shqiptarët e Kosovës i
10 kanë njohur dhe e kanë përjetuar dhunën në të shkuarën dhe
11 mund të krijonin të ardhmen pa një gjë të tillë. Po ka patur
12 shqiptarë të tjerë të Kosovës që e kanë dënuar këtë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një pyetje
14 shumë të shkurtër ju lutem.

15 Z. KEHOE: [Përkthim]
16 PY. Dhe personi i cili ka bërë, pra, personi i cili ishte si
17 pjesë e qeverisë provizore të përkohshme ishte Thaçi, jo
18 Rugova, jo Bukoshi, ishte ai i cili ka bërë deklaratat për
19 ndalimin e dhunës, për krijimin e një shoqërie shumetnike dhe
20 për ndarjen e personave të cilët ishin në konflikt?

21 PË. Jo, ka patur të tjerë atje. Ka patur të tjerë.

22 PY. Unë jam dakord me juve. Është Hashim Thaçi Së bashku me
23 të tjerët i cili ka thënë ndaloni dhunën, krijimin e një
24 shoqërie etnike.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe, ju

1 po e thoni këtë për herë të dytë dhe ju ka përfunduar koha.

2 Z. KEHOE: [Përkthim]

3 PY. Z. Abrahams, faleminderit për pyetjet tuaja.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
5 ju e keni fjalën.

6 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson:

7 Z. EMMERSON: [Përkthim]

8 PY. Unë po ju bëj pyetje të cilat lindin nga pyetjet dhe
9 përgjigjet që i keni dhënë Gjykatësit Mettraux, 7576, rreshti
10 23. Është përmendur shkarazi nga z. Kehoe kur jeni pyetur për
11 rëndësinë që ju dhe The Human Right Watch i keni treguar
12 saktësisë së komunikatave dhe deklaratave të lëshuara nga UÇK-
13 ja. Përgjigja juaj është që:

14 "Ne i kemi kushtuar vlerë të madhe këtyre komunikatave
15 pasi ato kanë dalë nga strukturat zyrtare, në këtë rast,
16 grupit të armatosur, pra. Deklarata e një pale në konflikte
17 janë informacion i rëndësishëm për ne padyshim".

18 Dua që të diskutojmë se çfarë nënkupton një gjë e tillë
19 për sa i përket frazës "informacion i rëndësishëm pa asnjë
20 dyshim" dhe, sidomos, lidhur me vlerën e madhe që The Human
21 Right Watch i atribuon këtyre deklaratave, pasi duket se ato
22 janë të strukturave zyrtare.

23 Dhe si një shembull, a mund të paraqesim një dokument të
24 cilin e kemi parë së fundmi. Që është P378, që komunikata
25 lidhur me dy gazetarët që bëhej fjalë për ndalimin e tyre për

1 një periudhë tre javore dhe ku komunikata thotë që ata janë
2 përpara Trupit Gjykues.

3 Z. TIEGER: [Përkthim] Më vjen keq, ky është koment. Nëse
4 ka pyetje mund ta bëjnë një gjë të tillë. Por komenti është i
5 papërshtatshëm.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni bëni
7 pyetjen.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim]

9 PY. Dua të pyes jeni specialist lidhur me të drejtën
10 humanitare ndërkombëtare?

11 PË. Po, për të hetuar lidhur me dhunimet e së drejtës
12 humanitare ndërkombëtare.

13 PY. Dhe si ekspert i së drejtës humanitare ndërkombëtare ju i
14 njihni strukturat ushtarake, apo jo?

15 PË. Së pari, unë nuk jam jurist dhe i referohem ekipeve
16 ligjore për hollësi të tillë, unë hetoj pretendimet lidhur me
17 shkeljet apo shkeljet e dukshme.

18 PY. Po megjithatë ju besoj se i njihni strukturat e një
19 ushtrie konvencionale, apo jo?

20 PË. A mund të shpjegoheni?

21 PY. Po. Po shpjegoj. A mund të na e tregoni, a mund të jepni
22 një përshkrim të *psy-ops* apo të operacioneve psikologjike.

23 Z. TIEGER: [Përkthim] Më vjen keq. Është jashtë pyetjeve
24 që ka bërë Gjykatësi.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ashtu

1 është.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më vjen keq, po nuk është ashtu,
3 pasi unë po bëj pyetje që kanë të bëjnë me këtë komunikatë dhe
4 unë po kërkoj nga dëshmitari që të më japë një shpjegim të
5 operacioneve psikologjike.

6 Ky dëshmitar në përgjigjen që i ka dhënë Gjykatësit
7 Mettraux ka thënë që The Human Right Watch i ka kushtuar një
8 vlerë të madhe vlerave, i ka kushtuar vlerë deklaratave të
9 nxjerra nga strukturat e njohura ushtarake.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe çfarë ka
11 të bëjë kjo me operacionet psikologjike?

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Sepse operacionet psikologjike
13 janë një pjesë e procedurës dhe e përgjegjësisë për të cilët
14 ka divizione të veçanta në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe
15 kjo nuk është e vërtetë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të shohim
17 nëse dëshmitari njih ndonjë gjë për këtë, pastaj ai thotë që
18 nuk merret me çështje të kësaj natyre. Megjithatë vazhdoni.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ai tha që nuk merret me çështje
20 juridike, por sigurisht që ju e dini një gjë të tillë, kur
21 merrni parasysh vërtetësinë e deklaratave dhe komunikatave të
22 nxjerra, që domethënë, që të gjitha formacionet ushtarake kanë
23 si pjesë të tyre dhe operacionet psikologjike.

24 PË. Po, kam dijeni mbi një gjë të tillë.

25 PY. Po ju jap një përkufizim. Dhe harroni se nga vjen po

1 është paragrafi i parë nga Wikipedia e operacioneve, pra,
2 psikologjike dhe të shikojmë nëse kështu e kuptoni këtë
3 situatë.

4 "[PSYOPS] janë operacione të cilët synojnë që të përçojnë
5 informacione të përzgjedhura ndaj lexuesve me qëllim që të
6 influencojnë motivimin dhe arsyetimin nga ana e tyre dhe nga
7 ana tjetër të ndikojnë edhe mbi sjelljen e qeverive,
8 organizatave, grupeve dhe fuqive të mëdha të huaja".

9 A është ky një përkufizim i mirë i informacioneve
10 psikologjike?

11 PË. Unë zakonisht nuk mbështetem mbi Wikipedia-n, por në këtë
12 rast jam dakord me këtë përkufizim.

13 PY. Po edhe unë ashtu veproj, dhe ju e dini që për sa i
14 përket ushtrisë amerikane, për shembull, ekziston një komandë
15 e veçantë ushtarake e cila përfshinë divizionin e 4 dhe të 8
16 dhe të 19 të forcave ajrore.

17 PË. Unë nuk i njoh këto njësi ushtarake, po operacionet
18 psikologjike janë pjesë e ushtrisë amerikane.

19 PY. Pra, bëhet fjalë për konceptin e vjetër të propagandës së
20 luftës për të krijuar një përshtypje.

21 PË. Propaganda është pjesë e konfliktit.

22 PY. Dhe tani quhet operacione psikologjike.

23 PË. Dakord.

24 PY. Pra, kur thuhet që Ukraina po fiton, pavarësisht se nuk
25 ka bërë progres në javën e shkuar apo jo, këtë duhet ta marrim

1 me rezerva, apo nuk është kështu?

2 PË. Dakord jam.

3 PY. Pra, duhet të mbani parasysh faktin që kur thoni që i
4 kushtojmë një vlerë të madhe komunikatave pasi vijnë nga një
5 burim zyrtar dhe janë informacion i rëndësishëm pa asnjë
6 dyshim të vetëm ju nuk po thoni që ato i trajtoni si diçka të
7 vërteta, por thjesht si të rëndësishme për analizën tuaj ku të
8 theksoni se është një deklaratë është e nxjerrë.

9 PË. Është e saktë. Kur unë them që është një informacion i
10 rëndësishëm ajo është për shkak se është nxjerrë nga një palë
11 apo një palë tjetër, një burim zyrtar mund të jetë NATO-ja apo
12 dikush tjetër, por kjo është e ndryshme nga saktësia.

13 PY. Synimi i së cilës mund të jetë për të manipuluar lexuesit
14 me qëllim që të krijohet një përshtypje lidhur mbi forcat që
15 ju keni në dispozicion dhe ky informacion mund të jetë i
16 pavërtetë?

17 PË. Po, mund të jetë e mund të mos jetë i vërtetë.

18 PY. Dakord. Dhe për arsye është që po të jetë i pasaktë është
19 hartuar për të krijuar një ndikim mbi armikun apo një palë
20 tjetër lidhur me vendimet e këtij që do të marrin.

21 PË. Dhe kjo mund të jetë një nga arsyet se përse mund të jetë
22 e pasaktë

23 PY. Dhe ju na thatë gjatë dëshmisë së ditës së enjte që në
24 atë kohë ju e keni kuptuar që ishte e vështirë që të kuptohej
25 nëse njësitet e dislokuara në terren kishin lidhje apo çfarë

1 lidhje kishin me një komandë qendrore apo jo, siç ishin në atë
2 kohë, apo jo?

3 PË. Po. Ashtu është.

4 PY. Dhe në atë kohë ju thatë se e keni përshkruar si një
5 jorajonalizim i fuqishëm që dominonte ju keni thënë sesi zonat
6 kishit fondin e tyre, blinin armët e tyre, ju na keni treguar
7 sesi niveli i organizimit dhe i komandës qendrore është
8 riparuar, si të thuash, nga marsi i vitit 1999?

9 PË. Ky ishte proces.

10 PY. Po, ashtu është e saktë.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të shqyrtojmë edhe një
12 herë në ekran dokumentin P378?

13 PY. E kemi diskutuar deri tani dokumentacionin që tregon sesi
14 në zonën e Dukagjinit ndërkohë që po krijohet ishte caktuar
15 një komandant për luftën kimike dhe biologjike, një komandë e
16 njësitit të antitankeve. Por këta ishin emra pirrikë, bosh apo
17 jo, siç mund të jeni dakord?

18 PË. Nuk i di këto emërime të bëra. Është hera e parë që
19 dëgjoj një gjë të tillë.

20 PY. Po e kemi dokumentacionin.

21 PË. Në qoftë se janë krijuar këto njësitet, unë nuk kam parë
22 ndonjë dëshmi që tregon që këto kanë ekzistuar në të vërtetë.

23 PY. Por nga ekspertiza juaj e specializuar a mund të jeni
24 dakord të thoni që këto ishin emra dhe funksione që i ishin
25 dhënë disa njerëzve për të krijuar përshtypjen që UÇK-ja ishte

1 më e mirëorganizuar sesa në fakt ishte e organizuar, është
2 kështu apo jo?

3 PË. Po, kështu është.

4 PY. A është diçka që e keni parë në terren, apo jo?

5 PË. Në përgjithësi UÇK-ja përpigëj ta paraqiste veten si
6 forcë e ligjshme ushtarake që luftonte për pavarësinë e
7 Kosovës. Për këtë nuk ka asnjë dyshim. Dhe jam përpjekur për
8 ta paraqitur veten si një forcë serioze luftarake dhe kjo
9 ishte pjesë e fushatës që kanë zhvilluar në atëkohë.

10 PY. Na thatë javën e shkuar se kryesisht ata ishin një grup
11 fshatrash të paorganizuar, pa asnjë zinxhir komandues, ju
12 thatë kështu, apo jo? Dhe thatë dhe pavarësisht këtyre
13 rrethanave po përpigëshin të krijojnë atë përshtypjen e një
14 force të armatosur të organizuar?

15 PË. Po.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është ngritur
17 Prokurori.

18 Z. TIEGER: [Përkthim] Më duket se po kalojmë në materiale
19 për të cilat dëshmitari ka folur por që nuk kanë të bëjnë
20 lidhur me komunikatat dhe është jashtë fushëveprimit të
21 pyetjeve të bëra.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Hidhet poshtë
23 ky kundërshtim.

24 Vazhdoni.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Faleminderit.

1 PY. Të shikojmë këtë dokument për një çast. E keni diskutuar
2 me z. Kehoe këtë çështje që thotë që është bërë gjyqi më datën
3 30 shtator dhe dëshmitë dhe aktakuza ka treguar që këta
4 persona nuk kanë qenë të ndaluar në atë kohë dhe, pavarësisht
5 ndryshimit të afatit kohor, kjo është pasaktësi, apo jo?

6 Megjithatë pyetja që kisha unë ishte konteksti rreth saj.

7 "Gjykata Ushtarake e Drejtorisë Juridike të Shtabit të
8 Përgjithshëm të UÇK-së bazuar mbi kërkesën e Prokurorit
9 Ushtarak..."

10 Pra, data mund të mos jetë e saktë, ndërkohë që bëhet
11 fjalë për një gjykatë ushtarake. A thatë që duket këtu që
12 është data nëntor, po, data 1 nëntor. Gjykata ushtarake e
13 drejtorisë juridike të UÇK-së. Po fillojmë me drejtorinë
14 juridike të UÇK-së. A do të çuditëshit po të mësonit se nuk ka
15 ekzistuar një gjë e tillë?

16 PË. Së pari, unë jam i detyruar që të shënoj që data 30
17 shtator nuk është e pasaktë, po është e papërputhshme.

18 PY. Dakord. Nuk e di se për çfarë ndryshimi bëhej fjalë po
19 vazhdoni. Nuk po ju pyesja për datën.

20 PË. Ju e përmendët datën prandaj.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e kuptoj
22 papërputhshmërinë.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim]

24 PY. Janë dy data të ndryshme dhe duhet të kuptojmë a është
25 pasaktësi apo thjesht mospërputhje?

1 PË. Kjo është mospërputhje.

2 PY. A jeni dakord, a nuk jeni dakord atëherë që është bërë
3 një gjë e tillë?

4 PË. Po. Kjo është një mundësi.

5 PY. Një nga mundësitë është që nuk ka ekzistuar informacioni
6 i saktë, apo jo?

7 PË. Po, ka mundësi.

8 PY. Është pjesë e një dokumenti i cili është hartuar dhe i
9 cili përmendet drejtoria juridike e selisë qendrore të UÇK-së
10 të datës 1 nëntor.

11 Pavarësisht bisedës që keni patur me z. Limaj i cili e ka
12 paraqitur, e ka përshkruar veten si një zyrtar juridik?

13 PË. Unë besoj që ka qenë kryetar i drejtorisë ligjore.

14 PY. Po ju thatë i sistemit të drejtësisë?

15 PË. Po i drejtësisë është, ashtë më kujtohet. Kryetar i
16 departamentit juridik apo kryetar i ekipit ligjor.

17 PY. Pavarësisht, siç do të provohet nga dëshmia, a është kjo
18 e përputhshme me atë që mund të themi që bëhej fjalë për
19 operacionet e psikologjike, të luftës psikologjike?

20 PË. Po. Ata kanë thënë që kanë patur një drejtor juridike
21 dhe nuk e di nëse ka patur, ka ekzistuar një gjë e tillë apo
22 jo. Kjo është një proces, por në qoftë se ata kanë pretenduar
23 që ka ekzistuar një drejtor juridike e cila më pas del që nuk
24 ka ekzistuar atëherë ka një numër shpjegimesh që mund të
25 jepen. Një nga të cilët një nga shpjegimet do të ishte në

1 operacion psikologjik.

2 PY. Pra, mund të ishte pikërisht kjo pjesë e atij përkufizimi
3 për të cilin ramë dakord që do të jepej në fakt informacion i
4 përzgjedhur dhe që synonte të mashtronte, të krijonte në një
5 farë mënyre përshtypjen që UÇK-ja ishte më e organizuar sesa
6 ç'ishte në të vërtetë, a ishte kështu apo jo edhe ky lloj
7 aktiviteti?

8 PË. Po.

9 PY. Mund t'i vëmë emrin çfarë të duam një emër psikologjik
10 por në fakt bëhet kjo është një gjë që ka ekzistuar për sa
11 kohë që ka ekzistuar lufta për sa kohë ka ekzistuar lufta apo
12 jo?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe nuk duhet të jetë pjesë e ushtrisë së Amerikës për të
15 krijuar përshtypjen që në qoftë se e tregon që je një ushtri
16 më e organizuar atëherë i krijojmë përshtypje të tillë
17 armikut. Dhe je dakord?

18 PË. Po, jam dakord.

19 PY. Dhe në Kosovë në vitin 1998, mund të kishte dy funksione:
20 E para për t'i treguar serbëve që ky ishte një armik i
21 vërtetë, një armik më i fuqishëm saç ishte në të vërtetë. A
22 jeni dakord?

23 PË. Po, jam dakord.

24 PY. Dhe e dyta dhe më e rëndësishme në fakt për t'ia bërë të
25 ditur NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara që ky është një grup i

1 organizuar ushtarak i cili duhet mbështetur me pajisje dhe me
2 stërvitje ushtarake. Që nuk është një ushtri thjesht
3 guerilase, siç e keni shpjeguar ju si një grup i paorganizuar
4 fshatrash pa një zinxhir të qartë komandues. Pra, që nuk ishte
5 ashtu. Po që ishte diçka që ka patur strukturën e duhur të
6 organizuar, pra, një strukturë me të cilën mund të punohet. A
7 është kështu apo jo?

8 PË. Sigurisht, sigurimi i mbështetjes nga fuqitë e huaj
9 ushtarake ishte një nga synimet kryesore të UÇK-së.

10 PY. Pra, një nga objektivat kyçe?

11 PË. Pa dyshim. Për të treguar veten se ishin partnerë të
12 besueshëm dhe për sa i përket stabilitetit, sigurisë, të
13 drejtave të njeriut, kjo do të ishte një shumë e rëndësishme
14 për ta pasur parasysh.

15 PY. Ju vetë e keni vërejtur që ndonjëherë ata bënë deklarata
16 dhe thonin që zbatonin të drejtën ndërkombëtare humanitare që
17 nuk ishin 100 për qind të besueshme, kështu?

18 PË. Këtë kam thënë në dëshminë time në këtë Gjykatë.

19 PY. Është e bazuar në atë që thatë ju, këtë keni thënë ju që
20 deklaratat lidhur me organizimin e tyre i bie që po ashtu të
21 mos jenë të besueshme?

22 PË. Jo, nuk mund të dalë në këtë përfundim.

23 PY. Po ta them unë ndryshe. Ti na the kështu kur po flisnim
24 për komunikatat dhe dokumentet, ju thatë që duhet të jemi
25 shumë të kujdesshëm se janë thjesht ndonjëherë manifestim i

1 operacioneve psikologjike, psy-ops, që po i themi shkurt dhe
2 këtë ju e merrnit parasysh?

3 PË. Ne merrnim informata nga të gjitha palët në konflikt dhe
4 sigurisht që kërkonim të hetonim më shumë.

5 PY. Patjetër. Madje dhe t'i mbështesnit, t'i konfirmonit.

6 Po ju a konfirmuat ndonjëherë faktin që në nëntor të
7 1998, ka pasur drejtori drejtësie pranë Shtabit të
8 Përgjithshëm të UÇK-së, që kishte gjykatë funksionale
9 ushtarake dhe prokurori ushtarake, pra, përveç bisedës me z.
10 Thaçi dhe z. Limaj? A bëtë ndonjë verifikim ju, a gjetët
11 ndonjë burim të pavarur informacioni për ta konfirmuar këtë?

12 PË. Ne kemi takuar pjesëtarë të policisë ushtarake.

13 PY. Po unë s'të bëra këtë pyetje.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Lejoni të
15 mbarojë përgjigjen.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Ne takuam persona përfshirë
17 ushtarë të policisë ushtarake, personalisht kam takuar
18 pjesëtarë të policisë ushtarake ku na treguan dhe
19 letërnjoftime që vërtetohej që ishin pjesëtarë të policisë
20 ushtarake.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim]

22 PY. Po ju e verifikuat dokumentet persona që pretendonin?

23 PË. Si supozohet ta bëj unë këtë gjë?

24 PY. Kur ua treguan këtë dokument e verifikuat ndonjëherë ju?

25 PË. Po.

1 PY. Kush e kishte nxjerrë?

2 PË. Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet sepse kishte persona të
3 ndryshëm që e kishin këtë letërnjoftim, këtë lloj dokumenti
4 identifikues dhe kështu u prezantuan.

5 PY. I kishte nxjerrë i njëjti autoritet?

6 PË. Po nuk më kujtohet se unë nuk i pashë të gjitha.

7 PY. Po kështu si po e thoni ju, i bie që dikush mund të
8 vendoste që unë jam përgjegjës, apo jo?

9 PË. Nuk mund ta them kështu. Po ne kemi parë veprime të
10 ndryshme në pikat e kontrollit të UÇK-së të cilat na lanë të
11 kuptonim që kishte një farë rregulli, koherence, e cila sipas
12 analizës që bëmë ne, do të thotë që ekzistonin urdhëresa.

13 PY. Po ti the në fund ishin koherente, jo në fillim.

14 PY. Jo me kalimin e kohës pamë një ndryshim dhe tregonte që
15 kishte veprime më të strukturuar apo koherence.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e
17 ndërprisni dëshmitarin.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, në këtë rast e kisha mbaruar
19 fjalinë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëni një
21 shkëputje të shkurtër nga mes pyetjes dhe përgjigjes.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim]

23 PY. Unë po ju thoja këtë gjë: Ju thatë në dëshminë tuaj që
24 fillimisht nuk kishte koherencë, por me kalimin e kohës në
25 dëshminë tuaj thatë që kishte një nivel më të lartë koherence

1 dhe ishte më e organizuar.

2 PË. Me kalimin e kohës vumë re që kishte një shkallë më të
3 lartë të organizimit.

4 PY. Okej. Si e bëtë ju këtë vlerësim? Kur vlerësonit ju që ka
5 pasur një mungesë organizimi, sepse na thatë që UÇK-ja nuk ka
6 qenë e organizuar dhe riorganizuar në mars të 1999 dhe në
7 cilën periudhë vutë re ju që kishte më shumë organizim?

8 PË. Patjetër. Udhëtimin e parë që pata në Kosovë në 1999, më
9 duket se në qershor, në qoftë se nuk e kam gabim. Më falni në
10 1998 desha të thoja, në qershor të 1998.

11 PY. Po.

12 PË. Në atë kohë vumë re një mungesë të lartë organizimi,
13 shihnim dhe anëtarë të UÇK-së fare pa uniformat, të paveshur
14 dhe kishte dallime në pjesë të ndryshme të rajonit të zonës.
15 Më pas, nga shtatori, vërejtëm një ndryshim, kishte më shumë
16 uniformitet, më shumë koherencë. Për shembull, këtu na mbaj
17 mend që ka qenë edhe periudha kur pamë policinë ushtarake në
18 Drenicë që na prezantuan policinë ushtarake në Drenicë. Në të
19 njëjtën kohë filluan të dilnin dhe urdhrat, po shpërndareshin
20 urdhra për gazetarët, për hetuesit e të drejtave të njeriut
21 dhe në këtë moment vumë re që kishte një shkallë më të lartë
22 organizimi.

23 PY. Kjo përputhet me atë që ka thënë z. Thaçi në takim që ata
24 po përpiqeshin të krijonin disa institucione për t'i bërë më
25 funksionale, apo jo?

1 PË. Asnjëherë nuk thashë që nuk pajtohem, asnjëherë nuk po
2 them që UÇK-ja, nuk e vë ë dyshim që UÇK-ja po përpiquej t'i
3 zhvillonte strukturat e veta sepse ishin disa grupe që
4 përpiqeshin deri në një moment dhe synonin që të ishin një
5 forcë ushtarake më e organizuar.

6 PY. Dhe ju mendoni se ka ndodhur në shtator të 1998, në fund
7 të ofensivës së verës nga ana serbe, më duket se the mars i
8 1999 në dëshminë tuaj?

9 PË. Nuk mund të jap me saktësi momentet kohore. Ndryshimi apo
10 zhvillimet ishin shumë dinamike.

11 PY. Faleminderit që përmendët policinë ushtarake apo këto
12 pikat e kontrollit, por qysh prej 1 nëntorit ju a kishit
13 ndonjë dëshmi që konfirmonte se në nëntor të 1998, në fakt,
14 madje shtator të 1998 sipas njoftimit për shtyp, ekzistonte
15 një drejtori drejtësie pranë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-
16 së, pranë të cilës funksiononte dhe një gjykatë ushtarake nën
17 përgjegjësinë e një prokurorie ushtarake. A gjetët ju burime
18 të pavarura për të verifikuar këtë pretendim me përjashtim të
19 takimit me z. Thaçi dhe z. Limaj.

20 PË. Informacionin e kemi bazuar në atë çka na thanë. Nuk na
21 lejuan t'i vizitonim të ndaluarit, pra, nuk ishim në gjendje
22 të verifikonim në qoftë se kishte një objekt ndalimi, a ku
23 ishin këto vende, apo ekzistonte apo nuk ekzistonte një
24 drejtori drejtësie.

25 PY. Pra, ju nuk gjetët asnjë informacion pas kësaj periudhe

1 kohore që të linte të kuptoje apo që të tregonte se ekzistonte

2 në fakt një drejtori drejtorie në shtator apo nëntor të 1998?

3 PË. Më falni çfarë po thoni?

4 PË. Në asnjë moment ju nuk keni ndeshur ndonjë informacion që

5 të konfirmojë faktin se ekzistonte drejtori drejtësie në

6 nëntor të 1998?

7 PË. Kur thoni keni gjetur çfarë doni të thoni?

8 PY. Okej. Po e bëj dhe njëherë pyetjen. A pajtoheni me mua që

9 duke pasur parasysh faktin që ishte shumë i rrezikshme

10 organizimi, domethënë, në fakt në thelb këto deklaratat synonin

11 këto deklaratat për synim kishin që të tregonin se kishte një

12 shkallë të lartë organizimi në mënyrë që të jepnin një imazh

13 të ndryshëm. Po ju vetë ju, a gjetët ndonjë burim të pavarur

14 për të verifikuar pretendimet për të parë nëse këto që ishin

15 thënë ishin të vërteta apo të sakta?

16 PË. Puna jonë është të dokumentojmë dhe të ekspozojmë

17 shkeljet që ndodhin në bazë të informacionit që mbledhim.

18 Struktura ishte për ne shqetësim është që personat të paktën

19 këta dy persona nuk ishin objekt i një procesi të rregullt

20 ligjor. Ky ishte thelbi i punës sonë. Dhe përfundimi që nxorëm

21 ne ishte që në fakt, nuk kanë qenë pjesë e një procesi të

22 rregullt ligjor.

23 PY. Do flasim dhe për këtë, po unë nuk po të pyesja për këta

24 dy persona. Unë po të pyesja dhe, në fakt, ju qëllimisht nuk

25 po i përgjigjeni pyetjes sime dhe po i përgjigjeni në mënyrë

1 mohore, jopohore. Po ta bëj pyetjen kështu tani.

2 A është e drejtë që ju nuk keni pasur asnjë dëshmi të
3 pavarur dhe as nuk gjetët ndonjë dëshmi që të vërtetonte
4 ekzistencën e një drejtorie drejtësie apo gjykatash ushtarake
5 apo prokurorësh ushtarakë në shtator, tetor, nëntor të 1998?
6 PË. Nuk më kujtohet.

7 PY. Faleminderit. A mendoni ju se ky është një shembull
8 tjetër kur UÇK-ja pretendonte se ekzistonin struktura që në
9 fakt nuk ekzistonin të vërtetë? A mund të jetë dhe ky rasti?
10 PË. Po. Dhe kështu mund të ketë qenë.

11 PY. Vazhdojmë. Folët për këta dy personat, më duket se kur iu
12 bëri një pyetje një nga Gjykatësit e Trupit Gjykses, ju thatë
13 që nuk e dinit pse nuk erdhi avokati në procesin në
14 çfarëdolloj procesi që të ketë qenë. Ju thatë që iu ishte
15 dhënë mundësia po nuk mori pjesë?

16 PË. Besoj se ajo që thashë unë dhe nga sa më kujtohet është
17 që të paktën në bazë të informacionit që na dhanë, ne na e
18 dhanë këtë informacion, na thanë që u lejuan që të kontaktonin
19 dikë dhe ky persona nuk erdhi, mbase nuk deshë o mbase nuk u
20 lejua. Po këtë informacion na dhanë ne.

21 PY. Siç e dini në çdo shtet kur nuk vjen avokati, kur nuk
22 është i pranishëm avokati në gjyq, personat kanë të drejtën të
23 zgjedhin ose të shtyjnë procesin, ose heqin dorë nga e drejta
24 për një avokat. Po këta dy persona hoqën dorë nga e drejta për
25 një avokat?

1 Z. TIEGER: [Përkthim] Për saktësi. Më duket se referenca
2 kishte të bënte me paraqitjen e një avokati gjatë gjykimit jo
3 me ndalimin, jo në stacionin policor.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] E themi si të duash. Në daç
5 ndalim, në daç proces ligjor.

6 PY. Unë po them këtë gjë. Që personat mund të heqin dorë nga
7 e drejta për të pasur një avokat të pranishëm ose mund të
8 përfaqësojnë veten?

9 PË. Po. Se mund ta bëjmë siç e bëri z. Milosevic ndonëse nuk
10 pati ndonjë rezultat.

11 PY. Fiks si Milosevic. Po. Atyre u është thënë mbase ose
12 "Mund të prisni tre ditë, ose një muaj, derisa të gjejmë një
13 avokat tjetër ose përfaqësoni veten". Dhe ata mund të thonë
14 "Nuk duam avokat. Heqim dorë nga e drejta për të pasur
15 avokat". Ju e dini çfarë ndodhi në këtë rast?

16 Unë nuk po them që ka ndodhur gjë. Unë thjesht po
17 përpiqem të kuptoj si e keni hetuar ju procesin e parregullt
18 ligjor sikurse e keni shprehur.

19 Gjithashtu, nëse janë të vërteta pretendimet që një prej
20 tyre ishte një person serb që ishte hetuar dhe besohej nga
21 TPNJ-ja se kishte kryer krime lufte në Kroaci, a mendoni ju se
22 ata do të ishin armiqësor në sjelljen e tyre ndaj UÇK-së?

23 Z. TIEGER: [Përkthim] Besoj se tani po spekulojmë dhe unë
24 i kundërshtoj këto.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

- 1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull.
- 2 PY. Nëse ju nuk e dinit a hoqën dorë nga e drejta për avokat,
3 a bojkotuan procesin ligjor, si mund të dilni ju në
4 përfundimin që procesi nuk përmbushi standardet ndërkombëtare
5 me kaq vendosmëri, duke mos e ditur çfarë ka ndodhur?
- 6 PË. Përfundimet dhe informacionet tona mbështeteshin në atë
7 që na treguan këta dy persona. U dhamë mundësinë të
8 shpjegoheshin, të na tregonin sesi ishte zhvilluar procesi
9 ligjor. Ata nuk thanë që kishin hequr dorë nga e drejta për të
10 pasur përfaqësim ligjor. Gjithashtu as nuk thanë që ishin
11 akuzuar për krime gjetkë. Pra, ne dolëm në përfundimet tona.
- 12 PY. Unë shumë të thjeshtë e kisha pyetjen. Duke mos bërë një
13 hetim të mirë dhe të duhur të fakteve themelore si dolët ju me
14 përfundimin se ka pasur parregullsi dhe të thonit që duheshin
15 liruar menjëherë pavarësisht se ç'kishin bërë ata, si dolët ju
16 në këtë përfundim pa pasur ju mundësi të hetonit faktet?
- 17 Unë e kuptoj pse e keni bërë ju, po a mendoni se është
18 pak e përshtatshme të dalësh në këto përfundime?
- 19 Z. TIEGER: [Përkthim] E kundërshtoj. Kjo pyetje është
20 bërë dhe më herët.
- 21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.
- 22 Z. EMMERSON: [Përkthim] E drejtë. E pranoj.
- 23 PY. Pyetja e fundit në lidhje me këtë. Në qoftë se mund të
24 ketë qenë spiunë, siç pretendohet, të paktën për Kroacinë, a
25 nuk mendon se është e drejtë dhe e ligjshme t'i ndalosh këto

1 persona?

2 PË. Unë s'i di pretendimet.

3 PY. Pretendimet që po të them unë. A mendon se për çështje
4 sigurie është krejt e ligjshme t'i ndalosh persona të tillë?

5 PË. Nëse kishe arsye për të besuar se po kryenin veprime
6 spiunazhi, po, e drejtë është.

7 PY. Faleminderit. Pra, nuk thanë që janë keqtrajtuar, nuk i
8 dinë faktet themelore çka ka ndodhur gjatë gjykimit edhe mund
9 të themi që faktet që iu kanë thënë janë të sakta dhe është e
10 ligjshme që këta të ndaloheshin? Faleminderit.

11 Kalojmë në një temë tjetër. Po ashtu lidhur me pyetjet që
12 u bëri Gjykatësi Barthe, në një nga pyetjet ju u përgjigjët si
13 në vijim, përshkruat ose më saktë evidentuat gjashtë kategori
14 bashkëpunëtorësh. A mund të na i kujtoni cilat janë gjashtë
15 këto kategori, se me sa duket ju i keni krijuar këto.

16 Z. TIEGER: [Përkthim] A mund të na jepni dhe referencën
17 për këtë pyetje sepse dëshmitari tha që unë nuk e di nëse mund
18 të evidentojë gjashtë kategori.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E drejtë
20 është.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] E drejtë është. Atëherë ja dhe
22 referenca. Referenca është 7653, Gjykatësi Barthe thotë:

23 "Faleminderit. Në paragrafin 82 e keni shprehur mendimin
24 tuaj. Gjatë viteve që keni bërë hulumtime në Kosovë,
25 kategoritë e ndryshme të personave në varësi të rrethanave

1 etiketoheshin nga UÇK-ja si bashkëpunëtorë dhe besoj se keni
2 përmendur gjashtë kategori”.

3 Mund të jenë pesë a gjashtë po a mund të na i thoni.

4 PË. Patjetër që mund t’ua them. Taksonomia lidhur me
5 bashkëpunëtorët është një spektër i gjerë.

6 PY. Këtë po e thoni ju. S’ka dalë njeri me këtë përfundim.

7 PË. Jo, është analiza ime kjo. Nuk do thoja që janë gjashtë
8 kuti të ndara me thikë. Gjashtë kategori të ndara me thikë apo
9 të mirëfillta në kuptimin e tyre të parë. Por po përsëris atë
10 që kam thënë, një nga kahet e spektrit janë personat që
11 punonin ose perceptohej se punonin për forcat e sigurisë
12 serbe.

13 PY. E dyta?

14 PË. E dyta ose jo e dyta e radhës në këtë vijë, në këtë
15 spektër, në këtë segment më saktë, janë ata që punonin për
16 shtetin, jo domosdoshmërisht për sigurinë po në përgjithësi.

17 Z. TIEGER: [Përkthim] A mund ta lini të përfundojë të
18 japë përgjigjen e vet.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Se po e thua
20 pa dashje mbase po apo jo, po ndërpret fjalën dhe është e
21 vështirë dhe për përkthyesit kur ka ndërhyrje nga një palë
22 tjetër.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është e drejtë, po.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Vazhdojmë pastaj në radhë janë
25 personat që kanë dënuar apo qortuar apo kanë falur

1 shprehimisht kundër UÇK-së. Më pas vijnë në radhë personat që
2 mbase nuk e qortonin aktivisht apo shprehimisht ama nuk e
3 përkrahnin. Nuk e përkrahnin qartë. Për shembull, nuk i jepnin
4 para atij fondit Mëmëdheu Thërret, apo ta përkrahnin në forma
5 të tjera duke u ofruar shtëpitë apo të ushqenin luftëtarët apo
6 ta mbështesnin fushatën ushtarake.

7 PY. Po thoni që dikush që nuk u hapte derën e shtëpisë
8 konsiderohej nga UÇK-ja si një shënjestër për t'u ndaluar,
9 burgosur dhe ekzekutuar? Këtë po thoni ju?

10 PË. Ajo që po them unë është në qoftë se merrej vendim, në
11 qoftë se vendosnin të mos u hapnin shtëpinë, u vendosej një
12 pikëpyetje, ishte si një re e zezë mbi shtëpinë e tyre sepse
13 besnikëria e tyre ndaj kauzës ishte me pikëpyetje.

14 PY. Ju keni përdorur fjalën "bashkëpunëtorë" që është fjalë
15 shumë e rëndësishme se Prokuroria pretendon ndërmarrje të
16 përbashkët kriminale.

17 Z. TIEGER: [Përkthim] Nuk mendoj se është e nevojshme që
18 avokati të shpjegojë arsyen pse po i bën pyetjet apo
19 përgjigjet. Mendoj se roli i tij është thjesht të marrë
20 informacion.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni me
22 pyetjet që burojnë nga pyetjet e Gjykatësve. Nuk kemi pse
23 flasim për ndërmarrjen e përbashkët kriminale këtu.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më lejoni ta shpjegoj. Kjo në
25 fakt është një nga pyetjet që ka buruar nga Gjykatësit sepse

1 Gjykatësi Barthe i ka lexuar një paragraf dhe ka dashur që ai
2 ta konfirmojë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk mendoj se
4 ka përdorur NKP-në në pyetjen e vetë.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull.

6 PY. Është e rëndësishme të kuptojmë se kë etiketonte UÇK-ja
7 si "bashkëpunëtor". A keni ndonjë shembull konkret ku UÇK-ja
8 të ketë etiketuar një person që s'ka hapur derën e shtëpisë si
9 bashkëpunëtor?

10 PË. Mund të jap shembuj.

11 PY. Jo, të kësaj situate dua, të këtij rasti.

12 PË. Unë do jap një situatë që mbase e ndihmon Trupi Gjykses,
13 ishte një listë me persona që nuk kanë dhënë, nuk kanë
14 financuar. Unë këtë e kam parë vetë, pastaj gjykoheni ju.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
16 mos e ndërprisni.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] U bë pak qesharake tani. Unë
18 thjesht po vijoj bisedën.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është e
20 pamundur që të pasqyrohet ndërhyrja juaj. Ndonëse e kuptojmë
